

THE VIABILITY OF DEMOCRACY IN POOR COUNTRIES FROM A GAME THEORY PERSPECTIVE

DEMOKRACIA NE VENDET E VARFRA, NEN KENVESHTRIMIN E TEORIVE TE LOJES

ZAMIRA CAVO*; BLERINA SINAIMERI**

*Departamenti i Politikës dhe Historisë, Universiteti Marin Barleti, Tirane

**Departamenti i Informatikës, Sapienza, Rome, Itali.

zamira.cavo@gmail.com

AKTET V, 4: 596 - 604, 2012

PERMBLEDHJE

Problemet e demokracisë sot janë në qendër të debateve të shumta jo thjeshtë politike por edhe akademike, filozofike e shkencore. Debati bëhet më i mprehtë kur kërkohen rrugë e mundësi të reja për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e këtij sistemi. Një ndër tezat e njohura sot në mendimin teorik mbi demokracinë ka të bëjë me skepticizmin e qëndrueshmërisë së këtij sistemi në vendet e varfra. Kjo tezë është shndërruar tashmë në një debat me qasje të ndryshme filozofike dhe ekonomike. Në këtë punim ne synojmë të bëhemi pjesë e këtij debati teorik mbi mundësitë që ka triumfi i demokracisë në vende të varfra, duke përdorur teorinë e lojës, si mjet ndihmues në konkluzionet tona teorike. Pyetja që shtrohet mbetet e njëjtë: Sa probabilitet ka sukcesi i demokracisë në një vend të varfër, dhe sa mundësi ka një individ, në një shoqëri të tillë, të bëjë zgjedhjen e duhur në politikë. Përgjigja e këtyre pyetjeve do të na japë mundësinë që të kalojmë në pjesën e dytë të punimit ku natyrshëm vjen pyetja: Më parë duhet luftuar varfëria dhe pastaj të luftohet për demokracinë, apo e kundërta? Në këtë pjesë synohet të reflektohet rreth tezës së Amartya Sen se: "Zhvillimi njerëzor është shumë më afër të varfërve se sa të pasurve".

Fjalët kyçe: demokraci, informacion, zgjedhje politike, teoria e lojës

SUMMARY

Democracy issues have become more and more important during the time. Nowadays, many political, academic and scientific debates are centered around this topic. The discussion is more challenging when asking for new methods and opportunities concerning the viability and the development of this system. Many recent theses and theoretical studies on democracy express skepticism toward the sustainability of this system in poor countries. Philosophical and economical approaches have been used in trying to exploit this idea. In this paper we aim to become part of this theoretical debate concerning the opportunities for a democracy system to flourish in poor countries. We will make use of game theory arguments in deducing our conclusions. The relevant questions are: "What is the probability of success of a democratic system in a poor country?" and "Is it really possible for an individual in such a country to make the right political choice?" The answer to these questions will naturally lead to address the following issue: Do we first have to defeat poverty and then ask for a democracy or viceversa? In trying to exploit this topic we discuss on Amartya Sen's thesis: the human development is closer to the poor than to the rich.

Key words: democracy, information, political choice, game theory.

Qëndrueshmëria dhe zhvillimi i demokracisë mund të konsiderohet pamëdyshje sfida të vendeve të vogla e të varfra. Prandaj dhe përpjekjet për gjetjen e instrumentave që promovojnë demokracinë dhe stimulojnë

zhvillimin, janë tema qendrore të kërkuesve të shkencave politike dhe ekonomike. Dy teoritë më të njohura në botë: pikpamja institucionale dhe pikpamja e zhvillimit (modernizimit), [Lipset 1959,

Engerman 2003, Gilman 2003] vijnë pothuaj në një konkluzion të përbashkët: “Varfëria ekonomike nuk siguron zhvillimin e demokracisë.”

Nuk do ndalemi për të vertetuar këtë teori që tashmë konsiderohet e pranueshme.

Ndarja mes këtyre dy pikpamkjeve konsiston në prioritetet që ata vendosin, pra në instrumentet që përdorin, për të mundësuar zhvillimin e demokracisë. Sipas pikpamjes institucionale, përparësi duhet të kenë institucionet, të cilat duhet të promovojnë ekonominë, zhvillimin e saj të shpejtë dhe në këtë mënyrë të sigurojnë fitoren mbi varfërinë.

Pikpamja e dyte, konsideron si parësore zhvillimin ekonomik, pra investimet në kapitalin fizik dhe human. Në këtë mënyrë stimulohet rritja ekonomike, pra zvogëlohet varfëria dhe për rrjedhojë garantohet zhvillimi i demokracisë. Sikundër thotë David Rieff : “Demokracia është nje gje e mrekullueshme, por nuk mjafton qe te shuaj urine dhe te mbush stomakun.” [Rieff 2005].

Pra nëse vendosja e demokracisë nuk con në uljen e nivelit të varfërisë dhe në sigurimin e nje zhvillimi të qendrushëm të ekonomisë, rreziku i rikthimit të diktaturave është real. Diktatura vërtetë është një gjë e tmerrshme por dhe uria nuk është më pak e tillë.

Prej 20 vitesh, vendet e ish demokracive popullore kanë kthyer kursin drejt demokracisë reale. Zhvillimi i tyre ekonomik, ka ndjekur modele të ndryshme. Shqipëria ,për nga mënyra se si po ecën, është një rast që përfaqëson një model, i cili meriton të studiohet.

Për të kuptuar se çfarë problemesh ka aktualisht Shqipëria në ekonomi dhe më tej në politikë, është e nevojshme të shikojmë vecoritë e saj të trashëguara nga sistemi ish socialist. Në këtë mënyrë mund të kuptojmë më mirë bazën e nisjes drejt demokracisë dhe të dallojmë modelin e zhvillimit të saj sot.

Vecorite specifike të Shqipërisë (të trashëguara dhe të konsideruara si bazë nisje), konsistojnë në:

1. Një vend i vogël gjeografik, por mjaftueshem i përshtatshem gjeopolitikisht. Kjo do të thotë se Shqipëria ka burime natyrore dhe humane sigurisht mjaft të limituara. Por nuk duhet harruar dhe pozicioni i saj i favorshëm gjeopolitik, i cili favorizon mjaftueshëm interesat ndërkombëtare ndaj vendit tonë.
2. Një popullsi e varfër, e cila e trashëgoi varfërinë individuale që nga sistemi totalitar. Sot në statistikat ndërkombëtare, Shqipëria konsiderohet ende si vend i varfër, ndërsa varfëria individuale është në shifra të larta. Sistemi totalitar e la individin të varfër ekstremisht (nen kufirin e minimimit te jetesës).
3. Një ekonomi që në nivelet makro, nuk trashëgoi borxh të jashtëm (borxhet e jashtme, në Shqipëri u krijuan pas vitit 1990. Të dhënat i referohen buletinit “Statistikat Fiskale të Qeverisë”).
4. Një shoqëri me një arsimit të kënaqshëm, dhe me një vdekshmëri foshnjore, që e bënte të krahasueshme me vendet e tjera të zhvilluara. (Te dhenat per arsimin nga 1950-1980 e vdekshmeria foshnjore po ne kete peridudhe [INSTAT 2003]).

Sikundër vërehet nga të dhënat, Shqipëria në sistemin totalitar mund të thuhet se ka kryer reforma të rëndësishme sociale. Nobelisiti Amarty Sen pohon se: “Ndryshimet e mëdha sociale (investimet publike), rrisin aftësitë e njëzëve për të bërë jetën që ia vlen dhe që është më pak e cënueshme.. “ [Sen 1962]. Kjo tezë nuk ka funksionuar në rastin shqiptar, pasi dhe pse reformat sociale u bënë me ritme të konsiderueshme (brenda një harku kohor të vogël u zhduk analfabetizmi, u sigurua sistem shëndetësor i kënaqshëm, i cili rriti ndjeshëm indikatorët e shëndetit publik në vend) sërish ekonomia mbeti në vend, duke degraduar drejt një kolapsi tërësor.

Pra shembulli shqiptar na tregon se reformta ose ndryshimet e mëdha sociale, me kahje pozitive, jo gjithnjë sjellin pasoja pozitive që ndikojnë në zbutjen e varfërisë.

Në fillimin e viteve 90, Shqipëria u përfshi në revolta për shkak të gjendjes së mjeruar ekonomike dhe varfërisë ekstreme në të cilën ndodhej vendi dhe individit shqiptar.

Në këtë këndvështrim, varfërinë, mund ta konsiderojmë pa frikë, një faktor madhor që çoi në revoltë popullore dhe më tej në rrëzimin e sistemit dhe në shndërrime demokratike.

Faktori tjetër që duhet marrë në konsideratë është faktori ndërkombëtar. Era e demokracisë që u përhap me shpejtësi në vendet ish vendet komuniste, nuk mund të mos ndikonte edhe në Shqipëri. Shkaku i revoltës popullore ishte varfëria, por kur faktori ndërkombëtar i jep kësaj revolte kuptimin e lëvizjes politike, transformimi sociopolitik i sistemit është i garantuar. Rrëzimi i sistemit komunist, pati pra shkak kryesor varfërinë dhe shkak të fortë mbështetës lëvizjet demokratike në vendet ish socialiste. Në këtë mënyrë demokracia u perceptua nga shqiptarët, si instrumenti i vetëm që do ti clironte nga varfëria. Kjo vihet re jo vetëm në psikozën popullore të shprehur në parullat: “Shqipëria si Zvicera pas 5 vitesh”, por edhe në politikat qeverisëse, të cilat, si do ti shohim më tej, u fokusuan jo në zhvillimin e ekonomisë, por në zbutjen e varfërisë së dukshme, duke përdorur mjete sipërfaqësore.

Që në vendosjen e sistemit, demokracia merr përparësi ndaj ekonomisë dhe shihet si mjete kryesor për zhvillim. Transformimi i thellë social ndodh kur qëllimet e lëvizjes janë të shumta dhe të ndryshme. Në Shqipëri, për t’ju përshtatur qëllimit të lëvizjes dhe mbi të gjitha trysisë psikologjike se “demokracia është çelsi i artë i zhvillimit”, vendi iu perkushtua demokratizimit të institucioneve për të siguruar “Lirite e mohuarara”. Prona dhe fjala e lirë zunë vendin e pare. Privatizimet dhe i gjithë legjislacioni që u lidh me te, u mjaftuan me krijimin e kushteve që biznesi të vepronte i lirë. E gjithë vëmëndja e politikës u përqëndrua në zhvillimin e institucioneve demokratike, si procesi elektoral, pluripartitizmi, media e lirë etj. Ky fakt na lejon të arrijmë në përfundimin se institucionet u zgjedhën si instrumente të zhvillimit të vendit, me besimin se ky zhvillim do të sillte edhe zhvillim të ekonomisë si dhe gjithashtu sigurimin e një

qëndrueshmërie të këtij zhvillimi. Në këtë mënyrë demokracia do të nxiste ekonominë e për rjedhojë do të zbuste varfërinë duke garantuar kështu vetë sistemin.

Problemi më i mprehtë, ai i varfërisë individuale, për një vend të vogël, presupozohet që mund të zgjidhet shpejt. Baza e këtij presupozimi qëndron në politikat ndërkombëtare të ndihmave ndaj vendeve të vogla (që për më tepër vinin nga një sistem diktatorial). Ndihamat e shumta që nuk ngurruan të vijnë nga mjaft vende të tjera, i krijuan mundësinë qeverive shqiptare që të zbuste në terma imediat, problemin e varfërisë individuale.

Sikundër pohon Jeffrey Sachs, (nje nga ekonomistët e zhvillimit më të mëdhenj te diteve tona,

drejtues i Earth Institute of Columbia University, gjithashtu ka qene këshilltar i veçantë për Kofi Annan.), këto ndihma shërbejnë si instrumente të zhvillimit të ardhshëm të vendit [Sachs 2006]. Por, Sach nuk na jep në tezat e tij anën tjetër të situatës. Nuk na jep pamjen nga poshtë, nga vetë realiteti i mëtejshëm i vendeve që marrin këto ndihma. Realisht këto ndihma, zbutën monetalisht varfërinë dhe krijuan një psikologji jo fort shpresëdhënëse për një zhvillim afatgjatë. Këto ndihma në formimin e një psikologjie qeverisëse të një modeli: “ne vazhdojmë demokratizimin dhe bota do të na ndihmoje në ekonomi”, koncept ky, tipik i qeverive të dala nga nje regjim totalitar dhe të papafta në menaxhimin e situatave të krizave, sidomos atyre ekonomike. Ndihamat dhe programet ndërkombëtare të ndihmës ndaj vendeve të varfra, që hyjnë në demokraci, sjellin impaktin imediat pozitiv, por kurrsesi nuk sigurojnë dot qëndrueshmëri të zhvillimit. Sot 20 vite më tej kemi këtë pamje:

Shqipëria është antare e NATO-s, siguroi lëvizjen e lirë për qytetarët por nuk ka marrë akoma statusin e vendit kandidat për në BE. Situta ekonomike e vendit parqitet në tregues jo të mire.

Duke iu referuar te dhenave nga FMN, bazuar në shkallën e papunësisë, Shqipëria renditet e pesta në rajon.




Figura 1. Shkalla e papunesise ne Shiperi [Burimi FMN. Grafiku: open.data.al]

Përsa i përket importeve dhe eksporteve, në raport me prodhimin e brendshëm bruto (PBB) importet kanë arritur në vitin 2010 në 37 % të GDP-se nga 38% që ishte në vitin 2009, me një rënie të këtij raporti prej 1%. Megjithatë, vazhdohet me një prirje relativisht të lartë për të importuar. Importet vazhdojnë të jenë disa herë më të mëdha se eksportet, duke dominuar tregun e brendshëm, si atë me pakicë ashtu edhe nevojat për pajisje, makineri e lëndë të para për sektorët e prodhimit e të shërbimeve të ndryshme.

Një situatë e tillë ekonomike ka në krah një panoramë politike që duket jo fort optimiste. Institucionet shqiptare edhe sot, kanë po të njëjtat probleme si 10 apo 15 vite më parë. Shumica prej tyre, nuk arrijnë standartet e vëna nga BE dhe mbi të gjitha, problemi alfa i demokracisë: procesi i elektoral, ka ardhur në përkeqësim, duke treguar se demokracia është në vështirësi serioze. Duke ju referuar shtypit të ditës në Shqipëri, qeverisja shqiptare po rrëshqet në autokraci të pastër, dhe partitë politike, si leva të rëndësishme të demokracive, janë shndërruar në parti rrogëtarësh, gjë që tregon se tregu politik është i deformuar maksimalisht për shkak të varfërisë. Një rrogë e garantuar është më mirë se sa një dyzinë parimesh, idesh e programesh. Shitblerja e votes, është e pashmangshme, ndërsa politika konsiderohet si biznesi më fitimprures. Panorama e përgjithshme socioekonomike pas 20 vitesh, kohë kjo e mjaftueshme për të parë progresin ekonomik, tregon se varfëria nuk është

kapercyer, se zhvillimi ekonomik ka mbetur në vend dhe se institucionet demokratike po bëjnë hapa pas, duke na vërtetuar tezen se: *varfëria mund të sjell bllokimin e demokracisë dhe shtrëmbërim të saj.*

Realisht është krijuar një rreth vicioz arsyesimi, që duket se bllokoi procesin dhe mban në ekuliber gjendjen; demokraci e limituar dhe zhvillim minimal.

**Prosperity depends on dynamism, dynamism on institutions* [Phelps 2005]

Varfëria vazhdon të mbetet një sifide edhe e këtij shekulli e madje dhe këtij mijvjecari. Kuptimi mbi të sigurisht nuk mund të jetë ai i një shekulli më parë. Kur flasim për varfëri, kemi parasysh jo thjeshtë dhe vetëm urinë, dhe pse ajo është prezente sot në shumë vende të botës, varfëria na intereson më shumë si përjashtim social, si privim i aftësive, sikunder pohon Amartya Sen. [Sen 2010].

A është Shqipëria një vend i varfër? Fatkeqësisht të dhënat na provojnë përgjigjen pozitive.

Në Shqipëri një ndër dy vetë mund të konsiderohet i varfër. Po të shikojmë të ardhurat për frymë duket se ka një rritje që nuk përkon me gjendjen reale të individit qytetar. Sipas të dhënave sot shqiptarët duhet të kenë të rreth 8 mijë dolarr të ardhura për frymë. Por gjendja reale flet për të kundërtën duke na provuar se ka një problem të madh në shpërndarjen e këtyre të ardhurave.

Përveç kësaj varfëria është shumëdimensionale dhe përveç të ardhurave dhe konsumit të ushqimeve apo artikujve të tjerë jo ushqimorë, individit është i ekspozuar ndaj riskut, edhe në shumë drejtime të tjera si strehimi, arsimimi, punësimi. Dekalogu i BE për të mos e klasifikuar një individ si të varfër kërkon:

1. Të ushqehet me mish, pule, peshk në cdo dy ditë.
2. Të ketë të paktën 2 palë këpucë.
3. Të ketë kapotë të ngrohtë të papërshkueshme nga uji.
4. Të blejë veshëmbathje të reja (jo të dorës së dytë).

5. Të mos ketë ftohtë për mungesë parash.
6. Të ketë një shtëpi në nivel të mjaftueshëm.
7. Të blejë dhurata për miqtë apo familjarët, të paktën një herë në vit.
8. Të ketë mundësi të zëvendësojë mobiljet.
9. Të mund të ftojë miq për drekë apo darkë një herë në muaj.
10. Të ketë një mbasdite për argëtim, njëherë në dy javë.




Figura 2. Tregues te ndihmes ekonomike per Shiperine. [Burimi: Open Data Albania ka kryer një hulumtim mbi numrin e familjeve që marrin ndihmë ekonomike në Shqipëri dhe shpërndarjen sipas qarqeve, bazuar në të dhënat e INSTAT dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.]

Të listuara në këtë mënyrë, me keqardhje do të na duhej të pranim se në Shqipëri këto standarte, mungojnë në një pjesë të madhe të familjeve shqiptare. Shqipëria ende vuan për mungesa elementare të një jetese sikundër janë: mungesa e energjisë elektrike, uji i pijshëm, siguria e jetes, drejtësia, etj. Mungesa e këtyre elementeve e shndërron në "individ në nevojë" çdo qytetar të Shqipërisë. Varfëria në këtë rast merr përmasa vërtetë shqetësuese.

Si përfundim mund të themi se:

Teza institucionaliste, e vënies parësore të institucioneve demokratike në një vend, duket se kur vendi është i varfër, i vogël, pra me resurse të limituara dhe me trashëgimi historike jo optimiste, nuk zgjidh dot problemin kyç të një shoqërie: varfërinë. Ky model sjell një lojë politike që

favorizon demagogjinë, madje e shndërron këtë, në model politik.

Teoria se tek një individ, të ardhurat e pakta, ndikojnë në aftësitë dhënëse, dhe aftësitë dhënëse ndikojnë në progres, e nëse mungesa e të ardhurave çon në pamundësi e arsimimit dhe kjo e fundit çon në mungesën e efektivitetit që mund të japë individi, padyshim do vinim në përfundime pazgjidhje dhe do të ishte e kotë të pretendojë të gjejë përparësitë në kohë, të faktorëve që ndikone në këtë situatë.

Po të bazohemi në teorinë e Lipsetit mbi faktorët që ndikojnë mbi demokracinë, do të na tërhiqte vëmendjen fakti që në planin mikro roli i lidershipit politik ka një rëndësi të madhe. Ky lidership politik, është padyshim pasqyrë e të gjitha tipareve kryesore të strukture sociale dhe gjendjes socioekonomike e kulturore të shoqërisë. Në një vend të vogël, të varfër, që del nga një sistem totalitar, ku varfëria shpërndahet në mënyrë të barabartë, lidershipi politik, që vjen në fuqi, ka përpara tij alternativën:

- (a) të veprojë në mënyrë demokratike, kushtëzuar kjo nga kultura, aftësitë e begraundi i tij personal dhe në këtë mënyrë, ti hapë rruge realisht përsosjes institucionale, duke mos vënë parësore përmirësimin e gjendjes së tij ekonomike, ose :
- (b) të sigurojë sa më shumë mundësi për përfitime personale, duke e përdorur politikën si mjet fitimi personal. (Figura 3.)

Ne Shqipëri:




Figura 3.

Në të dyja rastet lidershipit politik i intereson imazhi demokratik, dhe kur kjo nuk arrihet atëherë është e favorizuar demagogjia, pasi në të dyja rastet, qëndrueshmëria në pushtet është padyshim, interesi kryesor i cdo lidershipi.

Zakonisht mendohet se në kushtet kur lidershipi politik priret drejt përfitimeve personale, problemin e zgjidh vota . Duke ju referuar teorisë së lojës le të shikojme një shembull [Przeworski 2009]: Të konsiderojmë sjellje e lidershimit në dy situata: situatë ekonomike, politike dhe sociale e mirë e vendit, dhe gjëndje krize. Nëse lidershipi sillet në mënyre korrekte dhe situata është e mirë, përfitimet e popullit janë maksimale. Nëse në të njëjtën situatë sjellja e lidershimit është e drejtuar përfitimeve personale atëherë përfitimet e popullit janë më të ulta por gjithsesi përfitimi është i lartë pasi situata ekonomike e vendit është e mirë. Në situatë krize, edhe pse lidershipi sillet në mënyre korrekte përfitimet e popullit janë të vogla për shkak të situatës. Së fundmi në situatë krize kur sjellja e lidershimit është e drejtuar përfitimeve personale, përfitimi i popullit është me i vogli i mundshëm. Një shembull numerik i këtij argumentimi jepet në tabelën e parë në Figura 4. Sic vihet re lehtësisht, votuesit nuk janë në gjëndje të dallojnë mes dy situatave: situatë krize dhe sjellje korrekte dhe situatë e mirë dhe sjellje për përfitime personale (tabela e dytë në Figura 4.). Votuesit e kanë të vështirë të kuptojnë nëse gjendja e tyre e personale e qëndrueshme ekonomike vjen si pasojë e kushteve të favorshme apo të sjelljes së pergjegjshme të lidershimit. Ndaj sistemi i votimit nuk mund të jetë një zgjidhje për të garantuar sjelljen korrekte të lidershimit.

Pra si konkluzion mund të pohojmë se: *Klasa politike në Shqipëri e përdori politikën si mjetin më të mirë të përfitimeve të saja personale .Prandaj sjellja e klases politike, është e prirur të shkojë drejt demagogjisë.*

Liria ekonomike dhe rregullat e dorës së fshehtë, që na përcjell Smith-i në teorinë e tij mbi tregun e lirë [Smith 1759], në kushtet kur vendi është i vogël dhe i varfër dhe kur klasa politike priret nga interesa personale, e cojnë individin drejt dy mundësive:

(a) të sillet lirisht, sipas rregullave të tregut dhe përfitimeve të tij personale, në këtë rast duhen marre parasysh aftësitë individuale, mundësitë reale dhe trashëgimia kulturore e tij, (b) ose të

synojë të sigurojë të ardhura të konsiderueshme, duke përdorur rrugë ilegale.

		Lidershipi politik	
		Sjellje korrekte	Përfitime personale
Situatë e mirë	Krizë	(1, 5)	(3, 3)
		(1, 3)	(2, 1)

		Lidershipi politik	
		Sjellje korrekte	Përfitime personale
Situatë e mirë	Krizë	(1, 5)	(3, 3)
		(1, 3)	(2, 1)

Figura 4. Në kopjen (a,b) : a perfaqëson përfitimin e Lidershimit dhe b perfaqëson përfitimin e popullit.

Në rastin e parë, individi, duke mos patur mundësi reale, pavarësisht lirisë së tij dhe pronës, ai arrin të plotësojë vetëm nevojat e tij për mbijetesë, ose për një jetesë të mirë, në rastin më të mirë. Po të shihen nga afër, në Shqipëri, të gjitha investimet individuale, janë kryer në banesa. Pra jo në gjenerim kapitali. Shkak është pikërisht, varfëria dhe mungesa e mundësive. Një individ i varfër, me një trashëgimi mentale totalitare, kur është mësuar që shteti të bëjë çdo gjë, e ka shumë të vështirë të orientohet në ekonominë e tregut, aq më tepër kur nuk gjen mundësi. Po të shikojmë si ka evoluar realisht tregu shqiptar, nuk është vështirë të dallohen disa faza:

(a) kjoskëzimin: ku të gjithë shesin dhe të gjithë blejnë mallra konsumi të përditshëm, që nuk i prodhojnë por i importojnë, (b) faza e klubeve e bareve, dhe benzinatave, dhe së fundmi (c) faza e kazinove dhe agjensive turistike.

Prodhimi mbetet gjithnjë e më shumë në nivele minimale. Mungesa e një strategjie ndihmëse

orientuese dhe organizuese ndaj ekonomisë e ka cuar këtë të fundit drejt një staniacioni real.

Në rastin e dytë individi, (sërisht na duhet të marrin parasysh faktorët që e kushtezojnë një sjellje të tillë), do të silltet natyrshëm drejt atyre mundësive, me anë të të cilave arrin të krijojë një fitim më të madh për të. Këto mundësi mund të koordinohen me interesat e lidershit politik për përfitime personale. Kjo sjellje e detyron lidershit politik të favorizojë ato drejtime të ekonomisë ku përfitimet e tij dhe të individit (mund ta quajmë në këtë rast të biznesit) janë më të mëdha.

Pa asnjë vështirësi korrupsioni shndërrohet në një mënyrë të politikbërjes. Për rrjedhojë, demagogjia shndërrohet në instrument të domosdoshëm për të bindur jo vetëm qytetarin, por edhe faktorin ndërkombëtar, se vendi po zhvillon institucionet demokratike.

Demagogjia çon në një rrenim të shpejtë të ekonomisë.

Sot përdoret si e dhënë nga institucionet shqiptare, (për të treguar zhvillimin ekonomik), fakti se në banka, shqiptarët kanë mjaftueshëm para të kursyera. Ky fakt i vë në pozita të favorshme bankat. Por dihet se ky nuk mund të jetë një tregues i besueshëm. Një varg studimesh në mbarë botën [De Soto 2001] kanë treguar se vendet e varfra, kanë shumë kursime, pasi të varfërit kursejnë. Pa u ndalur në faktorët që e favorizojnë këtë dukuri, është e kuptueshme se ky tregues, pra kursimet në banka, nuk janë tregues i gjendjes së mirë ekonomike dhe nuk mund të konsiderohen si një arritje ekonomike e demokracisë.

Zhvillimi ekonomik, padyshim lidhet në rradhë të parë me aftësinë e vendit (ekonomisë) për të prodhuar kapital. Duke ju referuar Nikollo Bellanca [Bellanca 2000], arsyeja kryesore pse vendet e varfra nuk arrijnë të prodhojnë kapital, është mungesa e operativitetit dhe shpirtit krijues e iniciues. Sepse dihet se të gjenerosh kapital do të thotë të nxjerrësh, të zbulosh dhe të mobilizosh për zhvillim, të gjitha burimet dhe kapacitetet e fshehura ose të keq menaxhuara.

Në Shqipëri, po të shikojmë të ardhurat dhe ku janë investuar ato, do të vërejmë me keqardhje se, importet janë shumë herë më të mëdha se eksportet [“Shkëmbimet Tregëtare për vitin 2010” faqe 9]. Pra shumica e kapitaleve që hyjnë në vend, dalin sërisht për mallra të konsumit të përditshëm që i nevojiten shoqërisë. Importi i mallrave ka qene burimi kryesor për furnizimin e tregut të brendshëm me artikuj, si ato të konsumit masiv e të përditshëm ashtu edhe në nevojat për rinovimin e aseteve të ekonomisë. Dhe në situata krize, të cilat fatkeqësisht edhe në botë janë më të shpeshta, qeveria për të kapërcyer gjëndjen e krizës, zvogëlon pikërisht fondet për shërbime publike, arsim, shëndetesi etj. Në Figurën 5 paraqitet buxheti për arsimin në Shqipëri, ndër vite, krahasuar me vende të tjera në rajon.




Figura 5. Shpenzimet për Arsimin në Shqipëri. [Burimi: Të dhënat për të gjitha shtetet, përveç Shqipërisë: EUROSTAT Të dhënat për Shqipërinë: Banka Botërore, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë Përpunimi dhe komentet: Open Data Albania]

Megjithatë të varfërit votojnë dhe në fushata elektorale marrin pjesë mjaftueshëm për të treguar se e vlerësojnë demokracinë. Në Shqipëri pjesmarrja në zgjedhje të përgjithshme shkon deri në 53%. Në këtë rast do të na duhej ti përgjigjeshim pozitivisht pyetjes së Amartya Sen se: “A janë të shqetësuar njerëzit e varfër për liritë politike dhe demokracinë?”.

Duket se me këtë pyetje jemi kthyer në pikën e nisjes së arsytimit tonë në këtë punim. Pra të

varfërit dhe pse e kanë kuptuar se demokracia nuk ka sjellë zhvillim cilësor në gjendjen e tyre ekonomike e sociale, ata sërish preferojnë demokracinë. Ky duket një paradoks, aq sa është e tillë dhe teza tjetër se: të varfërit i intereson më shumë xhepi i tij se sa demokracia.

Nëse do të rikapitulonim një përgjigje për pyetjen që ngritëm në fillim të këtij punimi: Cila rrugë do të duhej të ndiqej nga një vend si Shqipëria, do të na duhej të ishim mjaft të kujdesshëm për të mos rënë në kurthor e dëshirave apo iluzioneve.

Zhvillimi ekonomik është një nevojë dhe domosdoshmëri, për të garantuar demokracinë. Por nëse do të perpiqeshim të argumentonim karakterin parësor të saj në një vend të varfër, do të na duhej të përballeshim me pyetjen: kush do ta sigurojë këtë zhvillim?

Ti referohemi faktorëve që ndikojnë në ekonomi. Sipas Lipsetit, forma e regjimit, lideri politik dhe faktori ndërkombëtar, luajnë një rol të madh. Atëherë teza do të shtrohej: Cili nga këta faktorë do të ishte në gjendje të vepronte pozitivisht në këtë drejtim? (Figura 6).

Po të marrim në konsideratë faktorin ndërkombëtarë, pak më sipër treguam se roli i këtij faktori është ndihmues por kurrësi jo vendimtar. Mbetet që lideri politik të luajë një rol të madh, gati deri në vendimtar. Por argumentuam se ky lideri sillet në mënyrë të tillë që nuk favorizon zhvillimin. Madje e mbështetur do të ishte edhe teza e ngjashme se “a mund t’ja lemë në dorë një qeverisje të korruptuar, celsat e zhvillimit ekonomik të vendit?” Dhe përgjigja vjen natyrshëm negative. Për rrjedhojë faktori që mbetet, por që gabimisht duket në hije, është demokratizimi i institucioneve. Dhe me institucione do të kemi parasysh mbi të gjitha median, shoqërinë civile, opinionin publik etj.

Nëse lideri politik është i korruptuar, nëse individ i kërkon mundësi që të fitojë duke ushqyer këtë korrupsion, mundësia e vetme është Liria dhe ushqimi gjithnjë e më shumë me këtë liri e opinionit publik. Vetëm nëse opinionin publik, kupton mekanizimin e situatës dhe thelbin e demagogjisë, atëherë vendi ka krijuar mundësinë

e një zhvillimi real e të qëndrueshëm politik dhe ekonomik. Përfundimisht mund të themi se:

Demokracia nuk është ilaci që shëron varfërinë, por varfëria nuk mund të sherohet pa demokracinë.




Figura 6.

BIBLIOGRAFI

- [1] Nicollo Bellanca “Dinamica economica e istituzioni” Franco Angeli (2000).
- [2] Paul Collier “The bottom billion” Oxford University Press (2008).
- [3] David C. Engerman “Staging growth: Modernization, development, and the global Cold War”, University of Massachusetts Press, (2003).
- [4] David Freidman “Law’s order” Princeton University Press (2001).
- [5] Nils Gilman “Mandarins of the Future: Modernization Theory in Cold War America” (Johns Hopkins University Press, Baltimore (2003).
- [6] J.H. Golthorpe “Study in the political economy of Western European nations” Oxford (1984).
- [7] Seymour.M.Lipset : “Economic Development and Political Legitimacy” (1959).
- [8] Seymour.M.Lipset “Economic Development and Political Legitimacy” (1959).
- [9] Seymour.M.Lipset “Union democracy: Doubleday”, (1962).
- [10] Edmund S. Phelps “The Economic Prosperity of Nations: Prosperity Depends on Dynamism, Dynamism on Institutions.” (2005).
- [11] Thomas Pogge, “Povertà mondiale e diritti umani”, Bari, Laterza, (2010).
- [12] Adam Przeworski, “A Better Democracy, A Better Economy” (1998).

- [13] Adam Przeworski. "The Poor and the Viability of Democracy," in Anirudh Krishna (ed.), *Poverty, Participation and Democracy*. New York: Cambridge University Press. (2009)
- [14] Adam Przeworski "Democracy as an Equilibrium." *Public Choice* 123: 253-273. (2005).
- [15] David Rieff : "At the Point of a Gun: Democratic Dreams and Armed Intervention ", Simon & Schuster (2005).
- [16] Jeffrey Sachs "The end of poverty" Penguin Books, (2006).
- [17] Amartya Sen "Zhvillimi si Liri" , Botime Dudaj" (2010).
- [18] Adam Smith "Theory of Moral Sentiment", pp. 184–5 in: *The Glasgow edition of the Works and Correspondence of Adam Smith*, Oxford University Press (1759).
- [19] Hernando de Soto, "Il mistero del capitale. Perché il capitalismo ha trionfato in Occidente e ha fallito nel resto del mondo", Garzanti, Milano, (2001).
- [20] Buletini Tremujor dhe Vjetor "Statistikat Fiskale të Qeverisë", Ministria e Financave.
- [21] "Kushtet e jetesës dhe pabarazia në Shqipëri : 2001" , Tiranë : INSTAT, (2004).
- [22] " Shkembimet Tregetare per vitin 2010", Ministria e Ekonomise, tregetise dhe Energjitikes, Drejtoria e Politikave te integrimit tregetar, (2011).